



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtora i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	03.04.2026
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Mars

I nderuar Kryetar z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.03.2026 deri me 31.03.2026

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Në kuadër të këtyre angazhimeve, janë mbajtur takime të rregullta të stafit profesional, ku janë trajtuar në mënyrë të detajuar projektet në fazën e përgatitjes, si dhe janë përcaktuar hapat konkret për implementimin e projekteve gjatë muajit mars dhe mujave në vijim.

Një ndër aktivitetet kyçe gjatë këtij muaji ka qenë puna e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, i cili ka shqyrtuar dhe vlerësuar gjithsej 68 lëndë të fermerëve që kanë aplikuar për kompensim të dëmeve të shkaktuara gjatë muajit janar në kultura të ndryshme bujqësore. Vlera totale e dëmeve të konstatuara arrin në 53,500.00 euro. Këto vlerësime janë proceduar në Kuvendin Komunal dhe tashmë janë në fazën përfundimtare, të gatshme për procedim të mëtejshëm në institucionet përkatëse (AME), duke reflektuar përkushtimin institucional për mbështetjen e fermerëve.

Në të njëjtën kohë, Drejtoria e Bujqësisë është duke bërë përgatitjet intensive për fillimin e procesit të aplikimit të fermerëve në Programin e Pagesave Direkte, i cili pritet të hapet së shpejti. Me qëllim të ofrimit të shërbimeve më efikase dhe reduktimit të pritjeve, është angazhuar staf shtesë, duke synuar lehtësimin maksimal të procesit të aplikimit për fermerët.

Gjatë muajit mars, kanë vazhduar edhe ndërhyrjet në lagje të ndryshme të qytetit të Lipjanit, në përputhje me kërkesat e qytetarëve. Në këtë drejtim, është punuar në trajtimin e qenve endacakë, duke realizuar identifikimin dhe vendosjen e matrikulave përkatëse, çka dëshmon trajtimin dhe kontrollin e tyre sipas kontratës.

Gjithashtu, Drejtoria e Bujqësisë ka proceduar lëndët për kërkesë pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për dy vendgjuetit, përkatësisht vendgjuetia lindore (Sokoli) dhe në atë perëndimore (Blinaja), me qëllim të marrjes së pëlqimit për vazhdimin e aktivitetëve të gjuetisë në këto dy zona.

Pas njoftimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për furnizim me fidane të ndryshme, Drejtoria e Bujqësisë ka paraqitur kërkesë për sigurimin e fidaneve dekorative, të destinuara për institucionet shkollore dhe hapësirat publike në Komunën e Lipjanit, me synim përmirësimin e mjedisit dhe rritjen e gjelbërimit urban.

Komisioni në kuadër të Drejtorisë së bujqësisë ka vazhduar aktivitetin në terren, duke iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve për vlerësimin e dëmeve në prona dhe kultura bujqësore, duke garantuar trajtim të drejtë, transparent dhe profesional të çdo rasti.